

Trepça Shoqëri Aksionare
Trepça Joint Stock Companies
Trepça Deoničarsko Društvo

Nr. 494 Data. 30.01.2023
Mitrovicë Mitrovica



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Trepça Shoqëri Aksionare
Trepça Deoničarsko Društvo / Trepça Joint Stok Company



**RREGULLORE PËR SHFRYTËZIMIN E UJIT INDUSTRIAL TË
NJËSISË BIZNESORE INDUSTRIA KIMIKE TË TREPÇA SH.A**

Mitrovicë, më 26.01.2023

PËRMBAJTJA

1. Qëllimi	2
2. Përkufizimet	2
3. Parimet e përgjithshme	3
4. Subjektet përfituese	3
5. Procedura e caktimit të tarifës për shfrytëzimin e ujit industrial	4
6. Kriteret për caktimin e lartësisë së tarifës për shfrytëzimin e ujit industrial	4
7. Mënyra e pagesës së tarifës mujore	4
8. Ndryshimi i kriterëve të operatorit	5
9. Dispozitat përfundimtare	5

Në bazë të nenit 95 paragrafi 1 të Ligjit Nr.03/L-212 të Punës, nenit 3 paragrafi 1.4 i Ligjit Nr.05/L-120 për Trepçën, Ligjit NR. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, nenit 20 të Ligjit nr.04/L-111 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, nenit 130 të Ligjit nr.06/L-016 për Shoqëritë Tregtare dhe nenit 8 të Statutit të Trepça Sh.A, Bordi i Përkohshëm Mbikëqyrës i Trepça Sh.A., në mbledhjen e mbajtur më 26.01.2023, miraton këtë:

Rregullore për shfrytëzimin e ujit industrial të njësisë biznesore Industria Kimike në Trepça Sh.A

Neni 1

Qëllimi

1. Kjo rregullore ka për qëllim të sigurojë tarifa racionale për shfrytëzimin e ujit industrial të Industrisë Kimike në Trepça Sh.A.
2. Me këtë rregullore përcaktohen procedurat dhe forma për dhënien në shfrytëzim të ujit industrial të Trepça Sh.A.

Neni 2

Përkufizimet

1. Shprehjet e përdorura në këtë rregullore kanë këtë kuptim:
 - 1.1 **Trepça Sh.A** – nënkupton Trepça Shoqëri Aksionare sipas Ligjit nr.05/L-120 për Trepçën
 - 1.2 **Uji industrial** – nënkupton ujë jo të pijshëm.
 - 1.3 **Shfrytëzimi i ujit industrial të Trepça Sh.A** – nënkupton qasjen në rrjetin e ujit industrial të Trepça Sh.A të cilat jepen në shfrytëzim sipas procedurave të përcaktuara me këtë rregullore.
 - 1.4 **Tarifë mujore** – nënkupton shumën e caktuar që duhet paguar në baza mujore për kyçje dhe shfrytëzimin e ujit industrial.

Neni 3

Subjektet përfituese

1. Shfrytëzimin e ujit industrial të Njesisë Biznesore Industria Kimike në Trepça Sh.A mund ta kenë te gjithë operatorët të cilët shprehen te interesuar për shfrytëzimin e ujit te tillë.
2. Të gjithë operatorët janë të obliguar që për shfrytëzimin e ujit industrial të lidhin marrëveshje bashkëpunimi me Trepça Sh.A.

Neni 4

Procedura e caktimit të tarifës për shfrytëzimin e ujit industrial

1. Tarifa për shfrytëzimin e ujit industrial caktohet nga komisioni i formuar nga Kryeshefi Ekzekutiv, për secilin vit, më të cilën do të informohen të gjithë shfrytëzuesit.
2. Mënyra dhe kushtet e pagesës së shërbimeve për një vit rregullohen me marrëveshje bashkëpunimi dhe dallojnë varësisht nga kriteret e përcaktuara ne nenin 5 të kësaj rregullore.
3. Marrëveshja e bashkëpunimit aprovohet dhe nënshkruhet nga Kryeshefi Ekzekutiv i Trepça Sh.A. me të cilën rregullohen obligimet dhe përgjegjësitë e palëve kontraktuese.

Neni 5

Kriteret për caktimin e lartësisë së tarifës për shfrytëzimin e ujit industrial

Caktimi i lartësisë së tarifës për shfrytëzimin e ujit industrial bazohet në këto kriteret:

1. Sipërfaqja për m²
2. Veprimtaria e operatorit ekonomik.
3. Sasisë se shfrytëzuar të ujit industrial.

1000
vic
vic

Neni 6

Mënyra e pagesës së tarifës mujore

1. Të gjithë operatorët ekonomik që e shfrytëzojnë ujin industrial të Ndërmarrjes Trepça Sh.A, janë të obliguar ta vendosin ujëmatësin e veçantë në gypin e tyre dhe në bazë tij varësisht sa ka harxhuar të paguajnë tarifën mujore.
2. Operatorët janë të obliguar të paguajnë paushallin deri në momentin e vendosjes së ujëmatësit.
3. Paushalli caktohet sipas procedurës së caktuar në nenin 4 të kësaj rregullore.

Neni 7

Ndryshimi i kritereve të operatorit


1. Në rast se operatori ekonomik ndryshon veprimtarinë apo ndonjë kriter tjetër që është baze për caktimin e tarifës për shfrytëzimin e ujit industrial duhet që në afat prej 15 ditësh të lajmëroj në organet e Trepça Sh.A për të bërë plotësimin e tarifës apo e kundërta.

Neni 8

Dispozitat përfundimtare

Kjo Rregullore për shfrytëzimin e ujit industrial të Industrisë Kimike në Trepça Sh.A, hynë në fuqi në ditën e aprovimit dhe fillon të aplikohet tetë (8) ditë prej ditës së publikimit në webfaqen zyrtare.

Kryesuesi i Bordit Mbikëqyrës të Trepça Sh.A



Dr.Sc. Bahri Hyseni

